



**Promovimi i të drejtave të
Privatësisë në Kosovë**

E financuar nga Fondi Kosovar për Shoqëri të Hapur

Mars 2012

(Përditësimi III, Korrik 2015)

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive

1. Hyrja dhe dimensionet evropiane
2. Pasqyrë e kornizës ligjore
 - 2.1. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDHP)
 - 2.2. Ligji për Telekomunikime
 - 2.3. Kodi Penal
 - 2.4. Kodi i procedurës penale
 - 2.5. Mungesa e një ligji specifik të Tele-medieve
3. Implementimi
 - 3.1. Vështërsia e kuptimit të operacioneve në përpunim të brendshëm të shënimeve
 - 3.2. Mosdija dhe mungesa e vetëdijës
 - 3.3. Termat ligjore të papërcaktuara
 - 3.4. Referimi tek Ligjet Shtesë
 - 3.5. Efekti legjitimizues i pajtueshmërisë së subjektit të të dhënave
4. Konkludimet dhe rekomandimet

Përmbledhja ekzekutive

Përparimi i jashtëzakonshëm në teknologjinë e telekomunikimit dhe informatikë ka pasur një ndikim të madh në botë; jeta pa telefon mobil ose lidhje interneti duket e paimagjinueshme sot edhe pse shumë pak nga ne kishim qasje në to para 20 viteve. Por kjo në anën tjetër ka ndryshuar tërësisht mënyrën se si të dhënat personale dhe private mblihen, ruhen dhe transmetohen, duke i ekspozuar ato në masë të madhe ndaj abuzimeve. Ligjet pra, janë një instrument i pazëvendësueshëm për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurinë e të dhënave personale.

Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) më 29 prill 2010 ndërsa agjencia shtetërore për mbikëqyrje dhe asistim në zbatimin e atij ligji është themeluar pas një viti. Ky projekt ka pasur për qëllim të rishikon legjislacionin më të rëndësishëm në lidhje me mbrojtjen e privatësisë që është në fuqi në Kosovë, ta krahasojë atë me kontekstin Evropian dhe të identifikojë pengesat eventuale në zbatim të tij. Duhet të theksohet sidoqoftë, se çështja e privatësisë është komplekse dhe shtrihet përtej perspektivës ligjore, në dimensione shoqërore, kulturore dhe politike.

LMDhP është parë në vete të ofrojë nivel adekuat të mbrojtjes dhe mbulon një sferë të gjerë të sfidave të mbrojtjes së të dhënave, pa i lënë anash cenimet e privatësisë siç është video-mbikëqyrja. Ca përmirësime janë të nevojshme, posaçërisht në trajtimin e sektorit privat dhe atij publik në mënyre të njëjtë dhe në barazimin e gjobave me shkallën e shkeljeve si dhe me zbatimin e marrjes së fitimeve shtesë nga ato shkelje. Përderisa janë vërejtur mangësi në tri pjesët tjera të legjislacionit të ndërlidhur: në Ligjin për Telekomunikime, në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurave Penale, ka nevojë për një rregullim të ofruesve të internetit, medieve në internet dhe të tregtimit elektronik, një ligj që do të ishte ekuivalent i Telemedia ligjit në Gjermani. Sido që të jetë, mund të thuhet se në përgjithësi ekziston një infrastrukturë ligjore solide në fuqi, e cila me disa përmirësime të nevojshme do të ofronte mbrojtje të mjaftueshme të privatësisë dhe të të dhënave personale.

Zbatimi i këtij legjislacioni në anën tjetër, do të ballafaqohet me një serë të vështirësive, disa me rëndësi më të madhe se tjerat. Mos-informimi dhe mosdija e theksuar tek ata që trajtojnë shënime si dhe tek ata që u trajtohen shënime është pengesa më e madhe praktike në zbatimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave. Në këto kushte, mundësia e trajtimit të shënimeve me pajtim të subjektit ngrit probleme të mëdha. Konkretisht, LMDhP lejon sikurse legjislacioni i BE-së trajtimin e çfarëdo të dhënave përderisa merret pajtimi nga subjekti, por duke pasur parasysh mungesën alarmante të vetëdijes, kjo mundësi paraqitet jashtëzakonisht problematike.

1. Hyrja dhe dimensionin evropian

Përparimi fenomenal i teknologjisë dhe shpeshimi i shprehive ditore, si dhe përpunimi i automatizuar i të dhënave, jo vetëm që kanë ngritur nevojën për të mbledhë dhe përpunua të dhënat personale, por kjo si rrjedhojë ka edhe krijimin e stoqeve të informatave të ndërlidhura mbi cilëndo nga shënimet e izoluara, duke e bërë të rëndësishme thujse cilëndo informatë për faktin se ato mund të bashkohen me të dhënat tjera pa shumë mund. Shpërndarja e të dhënave personale pa lejen e subjektit mundet prandaj të ketë pasoja të rënda për subjektin, si për shembull vështirësimi i kushteve apo edhe refuzimi i plotë i kredive dhe policave të sigurimit shëndetësor apo jetësor. Nuk bën harruar edhe interesin e qytetarit të mbetet jo tërësisht i ekspozuar ndaj shtetit dhe i monitoruar nga ai pa kufizime. Prandaj, një kornizë ligjore adekuate e ndërlidhur me mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave personale është një parakusht i domosdoshëm për secilën demokraci kushtetuese dhe një komponentë thelbësore e sundimit të ligjit. Sidoqoftë, edhe ligjet e përpiluara më së miri dinë të bëhen të padobishme pa një pranim dhe zbatim të rregullt.

Për më shumë, asnjë shet Evropian nuk mundet të analizohet mirë në asnjë kontekst ligjor pa pasur konsideratë për dimensionin mbi-kombëtar. Instrumenti rregullues dhe vendimtar për çështjen në fjalë në Bashkimin Evropian është direktiva e BE-së 95/46/EC në mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe në transferim të lirë të atyre të dhënave. Por edhe pse është adoptuar si mjet legjislativ i direktivës, Gjyqi Evropian i Drejtësisë ishte i qartë në vendimin e tij të 24 Nëntorit 2011 (rasti C-468/10 dhe C-469/10 – “ASNEF”), se direktiva 95/46/EC synon harmonizimin e plotë (siç është përcaktuar në vendimin e 6 Nëntorit 2003, rasti C-101/01 – “Lindquist”) deri tek ndalimi i çdo ndryshimi të principeve të saja fundamentale, edhe në rast kur ato kërkojnë më shumë mbrojtje. Rrjedhimisht, çdo synim për të arritur standardet dhe praktikat më të mira Evropiane duhet të orientohet kah direktiva e lartpërmendur. Si shtesë, një rregullore¹ që është në përpilim e sipër do të zëvendësojë këtë direktivë me një nivel më të lartë të mbrojtjes dhe pasi që të zbatohet do të ketë më shumë ndikim në shtetet anëtare dhe do të len edhe më pak hapësirë për konkretizim individual. Në të njëjtën kohë, drafti paraqet një serë të fuqive konkretizuese për Komisionin Evropian. Sidoqoftë, procesi i hartimit pritët të zgjatë edhe dy vite tjera, me dy vite shtesë të periudhës kalimtare për të hyrë në fuqi (shih Nenin. 91 të draftit).

¹ Proposal for a Regulation of the European Parliament and the Council on the protection of individuals with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data (General Data Protection Regulation), COM(2012) 11 final. Available at: http://ec.europa.eu/justice/data-protection/document/review2012/com_2012_11_en.pdf.

2. Pasqyrë e kornizës ligjore

Përpos ligjit të përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, që është edhe në fokus të kësaj analize, ekzistojnë edhe disa ligje specifike të rëndësishme që mbulojnë çështje me rëndësi për privatësinë dhe trajtimin e të dhënave personale në kontekstin sektorial dhe ato po ashtu janë mbuluar në këtë raport.

2.1. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP)

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji Nr. 03/L-172), i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 29 prill 2010 është dokumenti qendror ligjor në lidhje me mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë së të dhënave në Kosovë. Ne përgjithësi, përmbajtja e tij reflekton vendimet kryesore të Direktivës së BE-së 95/46/EC dhe siguron nivel adekuat të mbrojtjes, duke akomoduar ndërlikueshmërinë e çështjes dhe sfidat praktike që hasen në trajtim të shënimeve. Në veçanti, ky ligj siguron rregullat e detajuara ligjore në procedimin e të dhënave personale (Neni 5 et seq LMDhP) me ndarjen e nevojshme të kategorive specifike të shënimeve (shënimet e ndjeshme personale) dhe vendimet e automatizuara individuale mbi informatat që jepen (Neni 10 LMDhP) dhe të drejtat e subjektit të të dhënave (Neni 21 et seq. LMDHP), në konfidencialitetin dhe sigurinë e procedimit (Neni 14 et seq. LMDHP), në Autoritetin Mbikëqyrës (Neni 29 et seq. LMDhP) dhe në obligimet e ndërlidhura për lajmërim (Neni 17 et seq. LMDhP), në sanksionet dhe mjetet ligjore (inter alia Neni 26, 27, 79 et seq dhe 92 LMDhP), në transferim të shënimeve shteteve të treta (Neni 51 et seq LMDHP), si dhe inter alia provizionet e veçanta të lidhura me marketingun direkt (Neni 59, 60 LMDhP), video mbikëqyrja (Neni 61 et seq. LMDhP), shfrytëzimi i tipareve biometrike (Neni 65 et seq. LMDhP), lidhja e sistemeve të ruajtjes (Neni 71 et seq. LMDhP) dhe zyrtari për mbrojtjen e të dhënave në trupat publik (Neni 74 et seq. LMDhP). Duke e pasur parasysh tërë këtë mbulim, çdo kritikë dhe sugjerim në këtë respekt do të kishin efekt dhe rëndësi të kufizuar.

Sidoqoftë, duhet përmendur se nuk është e mjaftueshme të detyrohen vetëm trupat publik të caktojnë zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave. Duhet të ketë rregullim adekuat edhe në sektorin privat (si psh. në biznese të mesme dhe më të mëdha). Në këtë kontekst, obligimi të përzgjidhet dhe caktohet një zyrtar i brendshëm për mbrojtjen e të dhënave duhet të kushtëzohet në bazë të numrit të përgjithshëm të të punësuarve që janë të angazhuar në përpunimin e të dhënave personale. Përderisa, në bazë të deklaratave nga Autoriteti Mbikëqyrës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDP), udhëzimet që përmbajnë rregulloret e ndërlidhura janë duke u zbatuar hëpërhë në formë të akteve nënligjore², inkorporomi i tyre në LMDHP do të paraqiste një mënyrë edhe më ekspeditive të trajtimit dhe do të korrespondonte me rëndësinë e çështjes.

Për më shumë, gjobat maksimale duken shumë të buta. Me qëllim të shërbimit efektiv të qëllimit të tyre dhe në mënyrë që të kenë efekt diskurajues të mjaftueshëm, ato do të duhen të ngritën. Në rast tjetër, cenimet e rënda të privatësisë nuk do të mundën të trajtohen në mënyrë

² Intervistë me Zëvendës Mbikëqyrësin Shtetëror Mentor Hoxhaj me 30 Mars 2012

adekuate dhe kontrollorët nuk do të kenë nxitje të mjaftueshme të zbatojnë ligjin, sidomos në situata ku cenimi rezulton në përfitim substancial financiar. Për atë arsye, mundësia e marrjes së përfitimeve të shtuara nga cenimi do të duhej të zbatohet.

PËRDITËSIM: Që nga përpilimi i këtij raporti, ASHMDP ka aprovuar një sërë të akteve nënligjore të cilat e lehtësojnë dhe/ose qartësojnë implementimin e LMDHP dhe legjislacionit tjetër përkatës. Lista e akteve nënligjore gjendet në ueb faqen e Agjencisë (<http://www.amdp-rks.org/web/?page=1.40&offset=0>), ndërsa një analizë e tyre vijon në përditësimin e ardhshëm.

2.2. Ligji për Telekomunikime

Ligji për Telekomunikime (Ligji Nr. 2002/7) mbulon disa aspekte të Mbrojtjes së të Dhënave në Kapitullin 13 Seksionin 74 et seq. Ky ligj në përgjithësi siguron nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes. Seksioni 74 i nënshton ofruesit e shërbimeve të telekomunikimit ndaj disa obligimeve specifike të konfidencialitetit dhe paragrafi 2 në veçanti kufizon marrjen e informatave dhe e bien në varshmëri me përmbajtjen, faktet ose rrethanat e mesazheve të transmetuara në një minimum absolut të nevojshëm për operimin e shërbimit individual të telekomunikimit. Por sidoqoftë, rregullorja në lidhje me Monitorimin e Trafikut në Telekomunikacion në Kapitullin 8 Seksionin 46 ngrit ca brenga në atë që athua baza ekzistuese ligjore mbi këtë veprim siguron qartësinë dhe precizitetin e nevojitur për përmbushjen e e qartësisë ligjore në kontekst të një mase kaq invazive. Prandaj, seksioni që thotë “ligjet e aplikueshme në Kosovë” duhet të modifikohet ashtu që të përcaktojë saktësisht cilët ligje aplikohen këtu.

2.3. Kodi Penal

Neni. 168 et seq. I Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25) në përgjithësi paraqet një bazë të mjaftueshme për ndjekjen e veprimeve të dënueshme në cenimin e privatësisë. Sidoqoftë, fakti që cenimi i privatësisë së personit tjetër përmes video mbikëqyrjes nuk konsiderohet si akt kriminal pa u zhvilluar në “hapësirat personale” (Neni 171 i Kodit Penal) paraqet një praktike të diskutueshme ligjore deri në masën ku e kundërshton vetë thelbin e ligjit. Rëndësia e kësaj teme është rritur rishtazi me rastin e Ansambles Valltare “Shota”, ku si duket (edhe pse e kontestuar nga drejtori) masat e video mbikëqyrjes janë aplikuar edhe në zheshtoret e valltarëve³. Autoriteti Mbikëqyrës e ka trajtuar çështjen dhe e ka vërtetuar cenimin e LMDhP duke urdhëruar ndaljen e përkohshme të mbikëqyrjes. Me këto njohuri në duar, cenimet e ashpra të privatësisë siç është mbikëqyrja në hapësira veçanërisht intime (psh zheshtoret, banjot, dushat, etj.) do të duhet të trajtohen nga Kodi Penal pa marrë parasysh natyrën “jo-personale” të hapësirave në fjalë. Sugjerohet pra që ligji të përshtatet.

³ cf <http://www.koha.net/?page=1%2C5%2C93254>.

2.4. Kodi i procedurës penale

Provizionet ligjore në kodin e procedurës penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26) lidhur me çështjen e mbrojtjes së të dhënave nuk nxisin në vete arsye për ndonjë vërejtje. Rregulloret e veçanta në këtë kontekst, të cilat mbulojnë masat teknike të fshehta të mbikëqyrjes dhe hetimit (Neni. 256 et seq.) janë secila të kushtëzuara me dyshimin e bazuar të shkeljes kualifikuese dhe përmbajnë qartësinë dhe precizitetin e kërkuar për të përmbushur kërkesat e sigurisë ligjore.

2.5. Mungesa e një ligji specifik të Tele-medieve

Mungesa e një ligji specifik të Tele-medieve vërehet mjaft shumë. Kjo mungesë duhet të zgjidhet për shkak të rëndësisë së madhe praktike dhe specifikave individuale të çështjes në fjalë, posaçërisht ndërlidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në internet dhe ambiente të ngjashme vizuale.

3. Implementimi

Edhe pse në pjesën e sipërme shihet se ekziston një kornizë ligjore e detajuar dhe në përgjithësi adekuate, zbatimi në praktikë has në një varg të vështirësive .

3.1. Vështirësia e kuptimit të operacioneve në përpunim të brendshëm të shënimeve

Një problem strukturor në implementimin dhe zbatimin e rregulloreve të ndërlidhura me mbrojtjen e të dhënave personale është fakti se një pjesë e madhe e proceseve të përpunimit të shënimeve janë parimisht të pakapshme për Autoritetet Mbikëqyrëse dhe subjektet e shënimeve për shkak të mungesës së qasjes në operacionet e brendshme të përpunimit të shënimeve. Se a është përmbushur obligimi ligjor i një kontrollori të fshijë shënimet personale në atë mënyrë që asnjë pjesë e shënimeve nuk mbetet e shfrytëzueshme apo e rindërtueshme është pothuajse e pamundur të ekzaminohet. Të dhënat personale mund të mblidhen, ruhen dhe çka është më me rëndësi, të barten tek pala e tretë pa dijeninë e subjektit të shënimeve. Sa më shumë trupa që posedojnë (ose ndajnë) të njëjtën informatë mbi të njëjtin person me leje, aq më vështirë do të ishte të zbulohet origjina apo fajtori edhe në cenimet më të dukshme. Pasi që nuk ka opsione reale për të adresuar këtë çështje të natyrshme, është thelbësore që subjektet e të dhënave dhe kontrollorët e ndërgjegjshëm të operojnë në bazë të shmangies së shënimeve dhe ekonomisë [kursimit] të shënimeve, si dhe të bëjnë procedurat në trajtimin e të dhënave sa më transparente që është e mundur. Zbatimi i obligimeve për ndarjen e informatave është një aspekt i rëndësishëm, por përfundimisht, mënyra më efektive e parandalimit të keqpërdorimit të të dhënave do të ishte që para së gjithash subjekti i të dhënave të mos i ndajë pa nevojë të dhënat e veta personale.

3.2. Mosdija dhe mungesa e vetëdijes

Përfundimisht, ndoshta pengesa më e madhe praktike në lidhje me zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave do të ishte mungesa e jashtëzakonshme e vetëdijes tek subjektet dhe kontrollorët e të dhënave. As subjektet nuk janë të vetëdijshëm mbi vlerën dhe ndjeshmërinë e të dhënave të tyre personale (dhe që janë të mbrojtur me ligj), e as kontrollorët nuk janë parimisht në dijeni mbi përgjegjësitë e tyre të ndërlidhura me çështjen, prandaj as që ka ndjenje të fajësisë kur mblidhen, ruhen dhe ndahen jashtëligjshëm të dhëna personale të mbrojtura.

Ç'është edhe më karakteristike, duke u bazuar në informatat e prezantuara në punimin mbi Ruajtjen e të Dhënave Personale në Kosovë në Gusht të 2011, asnjëri nga zyrtarët kyç në procesin e regjistrimit të popullatës e as ata në Autoritetin Rregullator të Telekomunikimeve që kanë qenë të angazhuar në regjistrimin e shfrytëzuesve të telefonisë nuk kanë dëgjuar për LMDhP e as për obligimet që rrjedhin nga ai ligj⁴. Në bazë të deklarimeve të qytetarëve, nuk është e pazakontë që ofruesit e shërbimeve të telekomunikimit të ndajnë të dhëna detaje personale (si emri, adresa, data dhe vendi i lindjes) mbi ndonjë subjekt vetëm me një thirrje telefonike.

Një anketë e realizuar në kushte strikte të anonimitetit (siç është kërkuar nga shumica dërmuese e subjekteve) që ka përfshirë bankat më të mëdha në Kosovë dhe kompanitë e sigurimit, duke mos përjashtuar edhe ofruesit e shërbimeve të internetit dhe komunikimeve, tregoi se sektori privat ka filluar të konsiderojë vetëm rishtazi çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale. Madje edhe zyrtarët e angazhuar në mbikëqyrje të zbatimit të rregullave (me shumë pak përjashtime) patën shumë njohuri të cektë mbi çështjen në fjalë. Stafi më i ulët i angazhuar direkt në mbledhjen e të dhënave personale ishte përgjithësisht i painformuar mbi kufizimet dhe cenimet potenciale.

Duhet cekur sido që të jetë, se AShMDhP kishte vendosur kontaktin fillestar në shumicën e rasteve dhe kishte njoftuar deri diku subjektet mbi çështjen.

3.3. Termet ligjore te papërcaktuara

Për më shumë, normativet e aplikueshme të kornizës ligjore përmbajnë shumë terme ligjore të papërcaktuara, që mbesin të hapura dhe kërkojnë interpretim si dhe konkretizim. Duke qenë të hartuara kryesisht nga ekspertë ndërkombëtar dhe të bazuara fuqishëm në ligjet e Bashkësisë Evropiane ose të shteteve anëtare individuale të cilat kanë legjislacione të elaboruara dhe koncepte të vërtetuara (dhe me përvojë) administrative, të themeluara përmes praktikës dhe përgjatë një periudhe të konsiderueshme, ato ju krijojnë trupave të papërvojë Kosovar vështirësi të papërballueshme në zbatim. Kur dëshiron të konkretizojë një koncept të

⁴ QKSS dokument i shkurtër i politikave i përpiluar nga Mentor Vrajolli dhe Sofije Kryeziu, faqe 3.

përputhshëm, një kontrollues mesatar i të dhënave në Kosovë nuk ka asnjë mundësi reale të vendosë në mënyrë adekuate a është një procedim specifik i të dhënave “i domosdoshëm” për shembull, në kuptimin ligjor dhe i lejueshëm në kontekstin e dhënë. Përderisa problemi është zbutur paksa me obligimin e secilit kontrollues që të mban katalogun e sistemit të ruajtës (Neni 17 LMDhP) dhe të njoftojë paraprakisht Autoritetin Mbikëqyrës (Neni 18 LMDhP), duke e lejuar mundësinë e aprovimit dhe përkrahjes nga ky autoritet përmes procedurave aprovuese, nuk janë të mbuluara të gjitha proceset e trajtimit të të dhënave e as nuk ka mundësi për vendime mbi raste individuale, prandaj edhe metoda e aplikuar përgjithësisht nuk ka mundësi të mbulojë suksesshëm problemin. Për më shumë, e tërë procedura në fjalë merr jashtëzakonisht shumë kohë.

Rekomandohet prandaj, që udhëzimet konkretizuese të aplikohen në nivel të abstrahimit mesatar dhe në formë të rregulloreve për sektorin publik dhe instruksioneve për sektorin privat. Këto udhëzime duhet të përmbajnë parametra matës konkret si dhe referimet tek shembujt konkret të termeve thelbësore ligjore me rëndësi praktike.

3.4. Referimi tek Ligjet Shtesë

Nevoja praktike për rregullimin e sektorëve specifik në fushën e ruajtjes së të dhënave rrezikon të krijojë ballafaqim të ligjeve e ndoshta edhe pamundësim të zbatimit të LPMDhP, sidomos kur e kemi parasysh se ligjet më të vjetra janë hartuar dhe aprovuar pa pasur në konsideratë problemet e tashme me mbrojtjen e të dhënave. Është e nevojshme prandaj të harmonizohen ligjet e sektorëve specifik (sikur ata të vjetrit, po ashtu edhe ata të aprovuar më vonë) dhe t’ju referohet në atë mënyrë që të barazohet niveli i mbrojtjes.

PËRDITËSIM: Kuvendi i Kosovës kishte miratuar ligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike me 28.05.2015, pas një debati dhe polemike në mes të qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Versioni përfundimtar do të jetë subjekt i një analize në përditësimin e rradhës. Ligji në fjalë mund të gjindet në ueb faqe të Kuvendit (<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-030%20sh.pdf>).

3.5. Efekti legjitimizues i pajtueshmërisë së subjektit të të dhënave

Në përputhje me rregulloret e ndërlidhura në nivelin evropian (Nenin 7 lit. Direktiva 95/46/EC), LMDhP e parasheh mundësinë e përpunimit të të dhënave personale në bazë të pajtueshmërisë së subjektit, përderisa është dhënë “çdo shprehje të lirë të vullnetit, të dhënë në mënyrë të qartë nga subjekti i të dhënave me të cilin ai ose ajo jep pajtimin për përpunimin e të dhënave personale” (Neni. 2 1.10 LMDhP). Pra, përderisa subjekti i të dhënave pajtohet siç ceket, ligjërisht lejohet çfarëdo përdorimi i të dhënave relevante. Por kur e marrim parasysh nivelin jashtëzakonisht të ulët të njohurisë së qytetarëve të rëndomtë mbi temën në fjalë, kjo krijon probleme serioze.

Para së gjithash, parakushtet specifike për pajtueshmërinë “e informuar” janë ne vete shumë vështire të përcaktohen. Por në çdo rast është esenciale për subjektin e të dhënave të kupton plotësisht se çfarë bën kur pajtohet të lejojë një trajtim specifik të të dhënave personale te veta.

Sidoqoftë, kjo nuk para-supozon një shpjegim të detajuar mbi natyrën, qëllimin dhe rrethanat e përpunimit të të dhënave, por mbështetet në aftësinë e subjektit të vendosë drejtë pasojat dhe implikimet a atij vendimi për te. Me fjalë tjera, pajtueshmëria e informuar kërkon njohuri, kompetencë dhe përgjegjësi në anën e kontrolluesit dhe një ndjesi për privatësi dhe vetëdije lidhur me vlerën e të dhënave personale, si dhe njohuri nga ana e subjektit të të dhënave mbi rreziqet e ndërlidhura me dhënien e tyre. Karshi prapavijës së situatës së përgjithshme në Kosovë, ne lidhje me mosdijen dhe mungesën e vetëdijes mbi çështjen e mbrojtjes së të dhënave, trajtimi si u përshkrua më herët do të ndodhte shumë rrallë në praktikë.

Për më shumë, kërkesa për pajtueshmërinë “e dhënë lirisht” është mjaft problematike në disa situata të zakonshme me mungesë të pajtueshmërisë së nënkuptuar. Një konstalacion tipik i këtij lloji do të ishte situata ku kemi relacione asimetrike të fuqisë (si për shembull në intervistë për punë apo negociata për kredi) ose situata të varshmërisë strukturale (si marrja e shënimeve gjatë pranimit në emergjencë) ku do të ishte absurd të mendohet se subjekti i të dhënave është në gjendje të vlerësojë efektin e dhënies së të dhënave ose edhe të mendojë të mos e jep pajtueshmërinë sado që i duket e panevojshme në një kontekst të caktuar.

Përderisa tema e pajtueshmërisë së dhënë në kushte të një informimi të mjaftueshëm është problematike edhe në shtetet që kanë të rregulluar mirë ambientin ligjor dhe administrativ, ku publiku ka vetëdije të mjaftueshme, në kushtet e tanishme në Kosovë këto probleme duken të pazgjidhshme. Prandaj, efekti legjitimizues i pajtueshmërisë, sado që është parimisht i rëndësishëm, në Kosovë do të duhej të kufizohet ashtu që të parandalohet trajtimi i tepërt i të dhënave. Korniza ligjore do të duhej të ndryshohet përkohësisht ashtu që legjitimimi i trajtimit të të dhënave nga ana e subjektit me pajtueshmëri do të duhej të lejohet vetëm në rastet ku subjekti kupton plotësisht thelbin, rëndësinë dhe konsekuencat e vendimit, ashtu që dhënia vullnetare e të dhënave nuk rrezikohet. Kjo praktikë do të kufizojë paksa autonominë e subjektit të të dhënave dhe do të paraqiste pjesërisht një kufizim të ligjit në tërësi, por këto disavantazhe do të mbuloheshin me rreziqet nga trajtimi i tepruar i të dhënave dhe interesin e subjektit të të dhënave ta parandalojë atë. Kjo do të rezultojë rrjedhimisht në ndryshimin e një ndër principeve thelbësore të Direktivës 95/46/EC (në atë që trajtimi i të dhënave është i ligjshëm po që se ato jepen me pajtueshmëri të padiskutueshme të subjektit), dhe ndryshimet e sugjeruara do të vendosin ligjet e prekura në mospërputhje me Ligjin Evropian de lege lata dhe de lege ferenda. Por, për Kosovën të arrijë në gjendje që do ta bënte atë shtet anëtar të BE-së dhe automatikisht ta nënshtrojë Ligjit Evropian, mangësitë e përmendura do të duhej të zgjidhen ashtu kështu, prandaj edhe kufizimet e përkohshme të efektit legjitimizues të pajtueshmërisë do të bëheshin të panevojshme.

Problemi mund të adresohet po ashtu me një interpretim strikt të kërkesave të tanishme për një pajtueshmëri, duke drejtuar në fund tek ndryshimet me efekt të njëjtë si ato të propozuara më parë. Por kjo do të nënkuptonte një aplikim të panevojshëm dhe të menjëhershëm të ndërmjetësimit (posaçërisht duke e ditur faktin që një konkretizim i termeve të papërcaktuara ligjore paraqet një problem në vetë në zbatim, vide supra) dhe do të sakrifikonte qartësinë

ligjore pa e ngritur autonomine e subjektit nëse zbatohet si është paraparë. Alternativa e parë është pra e preferuar.

4.1 Konkludimet

Korniza ligjore mbi mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Kosovë është përgjithsisht adekuate. Zbatimi në praktikë në anën tjetër has në disa vështësi:

Para së gjithash, është problemi i vështësisë së kuptimit të proceseve të brendshme të trajtimit të shënimeve, që mund të adresohet vetëm me politika të bazuara në shmangje dhe racionalizim të dhënies së të shënimeve nga ana e subjektit.

Përfundimisht, ndoshta pengesa më e madhe praktike në lidhje me zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave do të ishte mungesa e jashtëzakonshme e vetëdijes tek subjektet dhe kontrollorët e të dhënave. As subjektet nuk janë të vetëdijshëm mbi vlerën dhe ndjeshmërinë e të dhënave të tyre personale (dhe që janë të mbrojtur me ligj), e as kontrollorët nuk janë parimisht në dijeni mbi përgjegjësitë e tyre të ndërlidhura me çështjen.

Përderisa tema e pajtueshmërisë së dhënë në kushte të një informimi të mjaftueshëm është problematike edhe në shtetet që kanë të rregulluar mirë ambientin ligjor dhe administrativ, ku publiku ka vetëdije të mjaftueshme, në kushtet e tanishme në Kosovë këto probleme duken të pazgjidhshme. Prandaj, efekti legjitimizues i pajtueshmërisë, sado që është parimisht i rëndësishëm, në Kosovë do të duhej të kufizohet ashtu që të parandalohet trajtimi i tepërt i të dhënave.

Për më shumë, normativet e aplikueshme të kornizës ligjore përmbajnë shumë terme ligjore të papërcaktuara, që mbesin të hapura dhe kërkojnë interpretim si dhe konkretizim.

4.2 Rekomandimet

- I. Nuk është e mjaftueshme të detyrohen vetëm trupat publik të caktojnë zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave. Duhet të ketë rregullim adekuat edhe në sektorin privat . Në këtë kontekst, obligimi të përzgjidhet dhe caktohet një zyrtar i brendshëm për mbrojtjen e të dhënave duhet të kushtëzohet në bazë të numrit të përgjithshëm të të punësuarve që janë të angazhuar në përpunimin e të dhënave personale.
- II. Me qëllim të shërbimit efektiv të qëllimit të tyre dhe në mënyrë që të kenë efekt diskurajues të mjaftueshëm, gjobat në LMDhP do të duhen të ngritën.
- III. Për më shumë, posaçërisht në situatat ku cenimi rezulton në përfitim substancial financiar, opsioni i marrjes së fitimit shtesë do të duhet të aplikohet.

- IV. Me qëllim të arritjes së qartësisë dhe precizitetit të nevojshëm për të arritur standardet e qartësisë ligjore, kur kemi të bëjmë me monitorimin e trafikut të telekomunikacioneve tek Kapitulli 8 Pjesa 46 e Ligjit mbi Telekomunikime dhe seksioni që referon në ligje tjera ose Rregullore të UNMIK-ut do të duhej të përcaktojë saktësisht cilat ligje janë të aplikueshme.
- V. Neni 171 në Kodin Penal duhet të ndryshohet ashtu që cenimi fundamental i privatësisë së personave me video mbikëqyrje të mos jetë ende i kufizuar tek veprimet brenda hapësirave personale të viktimës. Do të duhej të aplikohet në hapësirat veçanërisht intime në përgjithësi.

PËRDITËSIM: Përderisa drafti i tanishëm i Kodit të ri Penal përmban një mirëseardhje të këtij sugjerimi në Nenin 205, lirimi që është bërë nga përgjegjësia kriminale në paragrafin 4 tek masat e përdorura për zbulimin e një shkelje kriminale duhet të specifikohet si dhe të përshtatet me interesin e matur në baza individuale të rasteve.

- VI. Duhet të adresohet çështja e mungesës së ligjit për telemediat për shkak të rëndësisë së madhe praktike dhe specifike individuale të çështjes në fjalë, posaçërisht në mbrojtën e të dhënave personale në internet dhe ambiente të ngjashme vizuale.
- VII. Ka nevojë të theksuar për kampanja informative që do të rrisnin vetëdijen tek popullata e Kosovës mbi temën e privatësisë dhe kornizës ligjore mbi të.
- VIII. Ka nevojë imediate për trajnimin e stafit tek të gjitha nivelet në sektorin publik dhe në atë privat mbi kornizën ligjore dhe zbatimin e saj në praktikë për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave.
- IX. Rekomandohet që udhëzimet konkretizuese të aplikohen në nivel të abstrahimit mesatar dhe në formë të rregulloreve për sektorin publik dhe instruksioneve për sektorin privat. Këto udhëzime duhet të përmbajnë parametra matës konkret si dhe referimet tek shembujt konkret të termeve thelbësore ligjore me rëndësi praktike.
- X. Është e nevojshme të harmonizohen ligjet e sektorëve specifik (sikur ata të vjetrit, po ashtu edhe ata të aprovuar më vonë) dhe t'ju referohet në atë mënyrë që të barazohet niveli i mbrojtjes
- XI. Efekti legjitimizues i pajtueshmërisë, sado që është parimisht i rëndësishëm, në Kosovë do të duhej të kufizohet ashtu që të parandalohet trajtimi i tepërt i të dhënave. Korniza ligjore do të duhej të ndryshohet përkohësisht ashtu që legjitimimi i trajtimit të të dhënave nga ana e subjektit me pajtueshmëri do të duhej të lejohet vetëm në rastet ku subjekti kupton plotësisht thelbin, rëndësinë dhe konsekuencat e vendimit, ashtu që dhënia vullnetare e të dhënave nuk rrezikohet